Kronikë

Lëvizte me pistoletë në Lushnjë, arrestohet 60-vjeçari, në hetim edhe 2 të tjerë (EMRI)

Arrestohet 60 vjeçari në Lushnje, lëvizte me pistoletë me fishekë në fole

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
5 Gusht, 09:50 | **Përditesimi: 5 Gusht, 10:06**

Share

Arrestohet 60 vjeçari në Lushnje, lëvizte me pistoletë me fishekë në fole

Sekuestrohet një arsenal armësh (4 armë gjahu pa leje, 1 armë zjarri pistoletë), gjerdanë arme gjahu me fishekë, municion luftarak, radio të ngjashme me ato të Policisë.

Njoftimi i policisë:

LEXO EDHE:
Zgjedhjet e Himarës, kutia që i surprizoi të gjithë, Tavo fitoi 98,3% të votave në fshatin Tërbaçi!

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë pas informacioneve se 1 shtetas lëviz i armatosur në qytet, menjëherë kanë organizuar punën për kapjen e tij. Në kuadër të operacionit "Guns", për këtë rast u kap në flagrancë dhe u arrestua shtetasi:

- Andon Mihali *60 vjeç, banues në fshatin Mërtish.*

Gjatë kontrollit fizik dhe të automjetit, shërbimet e Policisë, i kanë gjetur këtij shtetasi 1 armë zjarri tip pistoletë me fishek në fole, dhe krehër të mbushur, 1 armë gjahu pa leje, municion luftarak, dhe një gjerdan arme gjahu me fishekë.

Më pas nga kontrolli i banesës së shtetasit A. M., shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë, gjetën dhe sekuestruan 2 armë gjahu pa leje, gjerdanë arme gjahu, municion luftarak, dylbi, dhe radio të ngjashme me ato të Policisë.

Gjithashtu për këtë rast u proceduan penalisht shtetasit:

-Q. G., 59 vjeç, dhe djali i tij, shtetasi K. G., 31 vjeç, të dy banues në fshatin Gurë.

Këta shtetas në momentin e kontrollit të automjetit, ishin pasagjerë dhe nga kontrolli i banesës së tyre u gjet dhe sekuestrua një armë gjahu pa leje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", në ngarkim të shtetasit A. M., dhe veprat penale "Moskallëzim i krimit", dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", në ngarkim të shtetasve Q. K., dhe K. G.

lajm ne perditesim...

Xh.K/I.M/Shqiptarja.com

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligjit 35/2016

Sondazhi i ditës:
Himara, i kujt është faji që 6 mijë votues ishin me karta të skaduara?

Institucioneve | Opozitës | Qytetarëve

Lajme të tjera

Namir Lapardhaja: Gjikurinë në Himarë nuk e mundi Tavo, e shiti Berisha

Namir Lapardhaja

5 Gusht, 10:20

Paris 2024/ Rezultati u vendos me fotofinish, Noah Lyles njeriu më i shpejtë në botë

5 Gusht, 10:17

U ekstradua nga Belgjika, GJKKO cakton arrest në burg për Leonard Dukën, rivali i Ervis Martinajt

5 Gusht, 10:16

Nga Pogradeci në Ulqin, piktori Sadik Kasa e feston 70-vjetorin me ekspozitën shëtitëse në trojet shqipfolëse

Armand Braho

5 Gusht, 10:08

Vdekja e 38-vjeçarit në Ksamil, Policia: Po presim ekspertizën! Gazetari i akuzon: Ngjarja u fsheh, u vra me 'JetSki'

5 Gusht, 09:58

'Apolonia' magjepsëse për turistët e huaj, numërohen 68 500 vizitorë për 7 muaj ! Turisti spanjoll: Ju keni shumë histori mbresëlënëse

Kristaq Thano

5 Gusht, 09:51

Ankaraja u kërkon bashkatdhetarëve të saj të largohen nga Libani

5 Gusht, 09:42

Kurti sot viziton Maqedoninë e Veriut

5 Gusht, 09:37

Paris 2024/ Kushtet e këqija në Francë, kampioni Thomas Ceccon fle në parkun e Fshatit Olimpik

5 Gusht, 09:33

Blinken në G7: Irani mund të sulmojë brenda 24-48 orëve

5 Gusht, 09:32

SKEDA/ Nga gjinekolog në politikan, karriera prej tre dekadash e Vangjel Tavos! Përplasjet në PS dhe rikthimi në parti si kryebashkiak i Himarës

5 Gusht, 09:30

Paris 2024/ SHBA dhe Kina 'kokë më kokë', renditja e medaljeve të fituara në Lojërat Olimpike pas ditës së nëntë

5 Gusht, 09:09

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje